



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

*Sesioni vjeshtor*

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 30.1.2019, me fillim në orën 17:00

Ndërtesa e Kuvendit , salla N-302

**PROCESVERBALI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Danush Ademi, zëvendëskryetarë i dytë, Fadil Beka, Haxhi Shala, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Shinik, Duda Balje dhe Veton Berisha, anëtarë.

**Munguan:** Xhelal Sveçla, Kujtim Shala, Igor Simiq, Jasmina Zhivković, Sasha Mil, Zoran Mojsilović dhe Slobodan Petrović .

Pjesëmarrës tjerë: Zijush Ahmeti KSZ dhe Celal Iliaz, Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Danush Ademi**, zëvendëskryetar i dytë I Komisionit.

**Rend i ditës:**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
  2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura me raport amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
  3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-114, për Zyrtarët Publik me raport amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
  4. **Shqyrtimi i Projektligjit 06/L-111 për pagat në sektorin publik me raport amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
  5. **Të ndryshme.**
- 
1. **Miratimi i rendit të ditës**

**Zëvendëskryetari i dytë- Danush Ademi**, konstatoi se rendi i ditës u miratua njëzëri, pa ndryshime.

**2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura me raport amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.**

**Zëvendëskryetari**, u shpreh se për faktin se këto tre projektligje kanë ardhur në procedurë të përsheptuar, konsideron se komisioni duhet ti shqyrtojë dhe miratojë në këtë takim, me qëllim që ti procedojë për miratim, në Komisionin Funksional.

**Zëvendëskryetari**, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

*Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:*

**R e k o m a n d i m**

Projektligji nr.06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

**3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-114, për Zyrarët Publik me raport amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media,**

**Zëvendëskryetari**, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-114 për Zyrarët Publik, me raport amendamentet të Komisionit Funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim konkret.

*Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:*

**R e k o m a n d i m**

Projektligji nr. 06/L-114, për Zyrarët Publik dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

**4. Shqyrtimi i Projektligjit 06/L-111 për pagat në sektorin publik me raport amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**

**Kryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin 06/L-111 për pagat në sektorin publik dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

**Rasim Selmanaj**, duke qen anëtarë edhe në Komisionin për Administratë Publike, dha sqarime se gjatë shqyrtimit të Projektligjit janë bërë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në aspektin e rregullativës ligjore. Ngriti si problem çështjen se ka qen kundër formulimit të amendamentit 27, ku dhe ka dhënë propozim që i njëjti të fshihet.

Ai përsëri doli me kërkesën e njëjtë, me propozim që të fshihet amendamenti 27, i raportin të Komisionit FunkSIONAL.

**Zëvendëskryetari**, dha për shqyrtim propozimin e deputetit Rasim Selmanaj, që të fshihet amendamenti 27, i propozuar në raportin e Komisionit FunkSIONAL

Pas diskutimeve, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni me shumicë të votave, nuk e miratoi të njëjtin.

Pas përfundimit të diskutimeve, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni me 7 vota Për, 1 votë Kundër të deputetit Fadil Beka, dhe asnjë votë Abstenim, nori këtë:

### **R e k o m a n d i m**

Me shumicën e votave, Projektligjit 06/L-111 për pagat në sektorin publik, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

#### **5. Të ndryshme.**

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 17:20.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

**Zëvendëskryetari i dytë i Komisionit,**

---

**Danush Ademi**